



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 523/Prot.
5

Tiranë, më 15 / 6 2016

REKOMANDIM

Nr. 13 datë 15 / 6 /2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 77-97 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.05.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, *Drejtorisë së Shërbimit Spitalor, Pogradec* me formë ligjore të aktivitetit person juridik,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit Nr.112, datë 06.05.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 16.05.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit, *Drejtorisë së Shërbimit Spitalor, Pogradec* me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit, *Drejtorisë së Shërbimit Spitalor, Pogradec* i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit Nr.112, datë 06.05.2016 të Komisionerit "Për kryerjen e hetimit administrativ" që do të ushtrohet pranë këtij kontrolluesi.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi nuk ka njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit mbi përpunimin e të dhënave personale, (në datë 06.06.2016, kontrolluesi ka kryer detyrimin për njoftim);
2. Kontrolluesi ka një rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e spitalit por nuk ka një rregullore specifike për mbrojtjen e të dhënave personale, për këtë të fundit ishin në proces përshtatshmërie me rregulloren tip të Komisionerit.
3. Kontrolluesi aplikon për punëmarrësit "Deklaratën e Konfidencialitetit";
4. Konstatohet se Kontrolluesi ka marrë masa teknike të përshtatshme për ruajtjen e dosjeve fizike të pacientëve në njërin prej ambienteve të kartotekës. Në lidhje me sistemimin e ambientit tjetër të kartotekës ishin çelur procedurat e prokurimit për rikonstruksionin e saj.

Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 21, 22 dhe 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverballi i bashkëngjiten këto dokumente:

- Kontratë me punëmarrësin (mjek, infermier, recepsion), bashkëngjitur Deklaratë Konfidencialiteti;
- Rregullore e brendshme funksionale e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor;
- Fotografi nga ambientet e kartotekës;
- Raport mbi procesin e Akreditimit (narrativ dhe tabelor);
- Karta Shqiptare e të drejtave të pacientit, e cila është publikuar vetëm në këtë spital, në ambientet spitalore dhe ato administrative.

Në lidhje me përmbajtjen e kësaj karte, ndër të tjera pacienti ka të drejta:

- 1- E drejta për akses;
- 2- E drejta për pëlqim;
- 3- E drejta për informim;
- 4- E drejta për privatësi dhe Konfidencialitet;
- 5- E drejta për ankimim;
- 6- E drejta për kompesim.

Të gjitha këto janë pjesë e parimeve bazë të Kodit të Procedurës Administrative, e për pasojë, dhe të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në datë 31.05.2016, u mbajt procesverbal nga ana e grupit të Inspektimit të Zyrës së K.D.I. M.D.P-së, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit Drejtorisë së Shërbimit Spitalor, Pogradec, në zbatim të kërkesave të Urdhrit nr.112, datë 06.05.2016 të Komisionerit.

Procesverballi u lexua në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit, të cilët u shprehën: “Do i paraqesim pretendimet tona në seancën dëgjimore”.

Vlen të përmendim faktin se ky spital nuk është në përmasat e spitaleve rajonale, por mbetet në funksion vetëm të qytetit të Pogradecit, dhe si i tillë ka statusin e spitalit sekondar, me emërtimin: Drejtoria e Shërbimit Spitalor. Ky spital ishte në proces akreditimi nga Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, Tiranë. Titullari i kontrolluesit me marrjen e Urdhrit të Komisionerit kishte filluar menjëherë marrjen e masave, dhe bashkë me stafin e tij ishin disponibël e bashkëpunues në funksion të grupit të inspektimit.

Me shkresën Nr.523/3, datë 13.06.2016, kontrolluesi, Drejtoria e Shërbimit Spitalor,Pogradec ka vënë në dijeni Zyrën e Komisionerit, për masat e marra në realizimin e detyrimeve të dala nga procesverballi i grupit të inspektimit.

Në zbatim të neneve 87 dhe 88 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, datë 30.04.2015, në datë 13.06.2016, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me pretendimet që kontrolluesi mund të ketë, në lidhje me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ.

Në seancën dëgjimore përfaqësuesi i kontrolluesit, nuk shprehu pretendime por paraqiti, Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe solli fakte se kishte filluar procesi i prokurimit për rikonstruksionin e ambienteve të arshivës sipas parametrave të duhur, duke

përbushur detyrimet që dalin nga ligji dhe konkretisht nga Urdhri Nr. 112, datë 06.05.2016 i Komisionerit.

Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, ndryshe nga kontrollues të tjerë, janë rikuperuar brenda një afati kohor relativisht të shkurtër, si dhe bashkëpunimi i kontrolluesit me grupin e hetimit ka qenë serioz dhe në zbatim të ligjit.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe në kuadër të problematikave të hasura në sektorin e shëndetësisë,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi Drejtoria e Shërbimit Spitalor, Pogradec të verifikojë dhe plotësojë rubrikat e Formularit të Njoftimit, dhe në vazhdimësi të përditësojë ato sipas ndryshimeve që mund të ndodhin gjatë ushtrimit të detyrës.
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi të formalizojë Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pogradec, pasi në këtë mënyrë ajo bëhet efektive, dhe detyruese për të gjithë punëmarrësit që aksesojnë të dhëna personale gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.
3. Kontrolluesi, detyrimet rekomanduese të dala nga ky akt i Komisionerit, duhet t'i realizojë brenda një afati kohor, prej 10 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi.
4. Në rast mos përbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 15.6 .2016

